



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 04.08.2020,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve dhe Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Agim Gashi, propozoi që të ndahen pikat e rendit të ditës për dy seanca, pikat që janë më me prioritet të mbresin për këtë seancë, e pikat tjera të mbresin për seancën në vazhdim.

Për këtë seancë është mirë të mbetet "Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2020 (TM2)" dhe këmbimet e pronave, ndërsa të tjerat të mbresin për seancën tjetër.

Kryesuesi tha se pikat e këmbimeve janë për shkak se po presin njerëzit me muaj të tërë, kurse raportet e ndërmarrjeve dhe drejtorive, mendoj që këto duhet hequr, të paktën një raport prej ndërmarrjes dhe një raport prej drejtorisë, por nuk kemi dashur me marrë këtë vendim pa e diskutuar me ju.

Agim Gashi kërkoi që të shtyhen për seancën vijuese Raporti i auditorit dhe Plani i eficiencës ose Informatat e drejtorive.

Genc Sherifi u shpreh i pajtimit që këto pika të rendit të ditës të ndahen për dy seanca.

Ai propozoi që të hiqen Informatat e drejtorive dhe Plani i eficiencës.

Osman Bllaca propozoi që të mbesin për seancën tjetër këto pika: Plani i eficiencës, Raportet e ndërmarrjeve, Raporti i Auditimit dhe Informatat e drejtorive.

Egzon Azemi propozoi që një report i ndërmarrjeve të mabetet për këtë seancë.

Sami Boroci u shpreh i pajtimit me me mendimin e zotëri Gashit, që të ndahen pikat për dy seanca.

Ai pati një propozim për një pikë tjetër, që në këtë situatë me u kujdesur për stadiumin e Hajvalisë, meqë e kemi votuar në Kuvendin komunal dhënien në shfrytëzim të këtij stadiumi. Jemi pajtuar që Federata në njëfarë mënyre ta ketë parasysh klubin, apo aktivitetin e klubit "Hajvalia", me e lënë në shfrytëzim stadiumit për atë komunitet, ku tani është bërë kompleksi, dhe nuk po ju lejohet shfrytëzimi nga Federata. Kam biseduar edhe me kryetarin dhe nënkyetarin për këtë çështje. Pasi që ne e kemi votuar si Kuvend, si do të mund t'i bënim presion Federatës që me ua lejuar shfrytëzimin, së paku fushat ndihmëse për stërvitje, sepse është një numër i madh i fëmijëve, mbi 100, që janë në shkollë të klubit.

Kisha dëshiruar të diskutojmë se a mund ta fusim si pikë në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, të paktën një kërkesë me ia bërë Federatës, që me i lejuar me shfrytëzuar këtë stadium. Ka qenë kjo kërkesë e të gjitha grupeve që me u përfshirë kjo në marrëveshje.

Agim Gashi theksoi se kjo nuk është natyrë e punës së Kuvendit, për shkak se vendimet e Kuvendit në raport me ato procedura, janë të pafuqishme ligjërishtë, por kjo punë do të ishte rregulluar në rast se Drejtoria e Kulturës, në kontakt me Ministrinë e Kulturës, nëse nuk ka pengesa të natyrës statutore të Federatës, atëherë besoj se ata e zgjidhin problemin me intervenimin e Drejtorisë, si pëprfaqësuese e Komunës. Kjo do të ishte rruga ligjore për me zgjidhur ndonjë problem eventual në mes të Federatës dhe atij komuniteti sportiv.

Sami Boroci u shpreh se ne si Komunë kemi investuar një buxhet për atë komunitet, ku ka qenë prej fillimit i destinuar për atë komunitet.

Kryesuesi tha se për këtë çështje duhet hulumtuar më tepër, sepse është raport juridik dhe se di sa ki fuqi juridike.

Egzon Azemi propozoi që njëra pikë e Raportit vjetor të ndërmarrjeve të mabetet për këtë seancë, ose "Pallati i Rinisë", ose "Termokosi", se besoj që janë shumë të rëndësishme raportet vjetore të ndërmarrjeve.

Fadil Gashi propozoi që pikat e rendit të ditës të mos ndahen në dy seanca, por pjesa e dytë me vazhduar menjëherë në ditën tjetër pas mbajtjes së seancës.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se këto pika të rendit të ditës që po tërhiqen, duhet të kalojnë në KPF e pastaj në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 3. Raporti vjetor i NPL "Pallati i Rinisë" SHA, për vitin 2019;**
- 4. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershor 2020 (TM2);**
- 5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut;**
- 6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut;**
- 7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës;**
- 8. Propozimrregullorja për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbërues;**
- 9. Të ndryshme**

Pika e parë.

Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbaleve të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politike Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi tha se sa i përket këtij Propozimvendimi, na e ka kthyer MAPL-ja brenda afatit ligjor, kështu që ka rënë dhe, përveç kësaj, ne nuk e kemi mbajtur brenda muajit mbledhjen e rradhës dhe ata i kanë filluar procedurat dhe e kanë dërguar në gjykatë.

Unë e kam përpiluar shkresën, që sot kam me ia dërguar sekretarit, për ta njoftuar se kjo as nuk është publikuar. Pra, është vendim që është i pezulluar, nuk ekzekutohet dhe këtë është dërguar në gjykatë, se kjo është e pezulluar dhe është në rend dite për mbledhje të radhës. Këtu e kemi një problem serioz, me shikuar dhe me diskutuar drejtpërdrejt me sekretarin. Në bazë të diskutimeve te ne që i kemi bërë, maksimum ne mundemi me ndryshuar çështjen e Vetëvendosjes, janë dy meshkuj. Veç këtu mundemi me bërë zëvendësim, dy me një, tash edhe me i bërë dy gra e një burrë, prapë brenda partisë po konsiderohet diskriminim.

Osman Bllaca tha se AAK-ja, AKR-ja dhe PDK-ja i kanë vetëm nga një burrë. Nga këta të tre, një duhet me qenë grua dhe dy burra.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Raporti vjetor i NPL “Pallati i Rinisë”, SHA, për vitin 2019.

Agim Gashi tha se ne e dimë që kemi raport të Komisionit aksionar, kur ta hapim materialin, na del se është i Bordit të drejtorëve. Ka dallim kjo punë. Raporti i drejtorëve është krejtësisht tjetër, ligji e përcakton këtë dallueshmëri. Neve na duhet Raporti i aksionarëve. Aksionarët i raportojnë Kuvendit, jo Bordi i drejtorëve. Bordi u raporton aksionareve, kurse aksionarët i raportojnë Bordit.

Vala Peshku theksoi se aksionarët e marrin, e lexojnë dhe e prezantojnë Raportin. Nuk e di që aksionarët përpilojnë raport.

Fadil Gashi tha se Bordi i raporton aksionarëve, e aksionarët i raporton Kuvendit.

Agim Gashi theksoi se Raportin aksionarët e shkruajnë dhe i raportojnë Kuvendit.

Kryesuesi tha se kështu si ka ardhur ky raport i Bordit, nuk është krejt në rregull. Aksionarët duhet ta kenë reportin e vetë, i cili i përfshin edhe Bordin, edhe aktivitetin e vetë në kuadër të bashkëpunimit që ka pasur me ndërmarrjen.

Agim Gashi u shpreh se po mungon përfaqësuesi i Zyrës ligjore. Zyra ligjore nuk duhet lejuar që një material i tillë të arkivohet në arkivin e Komunës, por është dashtë me iu thënë aksionarëve merreni reportin e Bordit, përpunojeni, bazohuni në ligj dhe nxirri të dhënat që i determinon ligji, pastaj me ua prezanton këshilltarëve, me iu dhënë mundësinë me debatuar për atë ndërmarrje, por neve na ka ardh Raporti i Bordit të drejtorëve.

Egzon Azemi shprehu mendimin se të dhënat kryesore nuk janë të përfshira në raport.

Unë e kam shikuar një incizim të një ndërmarrjeje në Kroaci, ku aksionari shpjegonte për ndërmarrjen publike prej se është zgjedhur ai aksionar, mbledhjen e parë kur e kanë mbajtur si aksionar, vendin, sa kanë votuar, me sa është hapur konkursi për Bordin e ndërmarrjes etj. Të gjitha këto informacione janë shumë të rëndësishme, që nesër-pasnesër nëse askund tjetër, të paktën me mbetur në arkiv, e fatketësisht ato nuk janë të përfshira në raport dhe realisht anëtarët e Bordit nuk kanë të drejtë me prezantuar raport.

Vala Peshku shprehu mendimin se duhet bërë një përbledhje, sepse aksionari mund të mos pajtohet me atë raport, mund të jetë i pakënaqur me punën e Bordit, nuk do të thotë gjithmonë me qenë mirë, mbledhjet kur janë mbajtur, çka është vendosur etj.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti vjetor i NPL “Pallati i Rinisë”, SHA, për vitin 2019, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 prill - 30 qershori 2020 (TM2).

Sa i përket Raportit finansiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2020 (TM2), sqarime dha Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, duke cekur se i ka përfshirë vërejtjet që i ka marrë nga mbledhja e kaluar, dhe janë përmirësuar aq sa ka mundur me i realizuar brenda ligjit i kam përmirësuar. Janë disa sqarime shtesë, përndryshe, nga ana e Komunës edhe pako dy është komplet e përgatitur proceduralisht, veç jemi duke pritur aprovimin, diçka të veçantë nuk ka. Unë jam shumë mirënjojëse, që nëse vëreni se është bërë ndonjë lëshim, deri në mbledhjen e Kuvendit mund të bëjmë ndonjë përmirësim ose ndonjë informatë shtesë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 prill - 30 qershori 2020 (TM2), dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të "Sima Com" dhe Adnan (Ali) Memedaliut, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Meliha Rrmokut, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për përkëmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ismail Shillovës, Faik Breznicës dhe Osman Breznicës, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimrregullorja për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese.

Agim Gashi tha se nuk është këtu e pranishme drejtoresha e Drejtorisë së Parqeve, e lexova informatën për punën e parqeve, e di se Komuna e Prishtinës është duke investuar inplantin për kompostimin e plehrave natyrore, d.m.th prodhimin e plehut për lule, për kopshte etj., ai quhet kompostim dhe nuk e pash atë informatë si informatë ekzistuese. Është dashur me u përmendur, se është mirë kur të jepen këto informata, me u përfshirë edhe informata për investime në fushën përkatëse e mos me ardhur informata e mangët. Ne përveç pronave që i kemi ofruar, p.sh. nuk e di që keni eliminuar drurë, të cilët me standarte urbane nuk parashihen të kultivohen nëpër hapësira urbane. Të gjithë drurët frytdhënës nuk parashihen të ekzistojnë në hapësira urbane, sepse fruat e tyre e kontaminojnë ambientin, se vet mbin, rritet, kultivohet dhe nuk është me standard urban. Kishte qenë mirë me i prerë. Po ashtu, do të ishte mirë që ndërmarrja "Hortikultura" me bërë punë cilësore, jo vetëm sasiore.

Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, dha sqarime lidhur me çështjet që i ceku zotëri Gashi.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për definimin e parametrave urban-arkitektonik të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

Procesmbajtësja
Shyharete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

